

 REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Prahuar i Primiteno Me Data	26.05.2025
Nr. Logpunkt Org. Broj	Numri Broj
02-052	02-399



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina – Municipality of Viti

**Raport për zbatimin e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2024 – 2026**

**MAJ, 2025**

Ky rapport pasqyron përbledhjen e aktivitetave të realizuara, nga Plani i Veprimit për Barazi Gjinore 2024 – 2026, në të cilin plan ishin të planifikuara gjithësej 72 aktivitete, ndërsa të realizuara 56

Aktivitetet e realizuara janë këto:

1. Aplikimi i masave affirmative për favorizimin e grave/vajzave në politikat sociale, si:

Në Rregulloret e aprovuara në Kuvendin e Komunës, janë të caktuara këto masa affirmative:

- **Rregullorja për ndarjen e Bursave për Studentët e Komunës së Vitisë, nr.01-019/246, e datës 02.03.2015, ka të përcaktuara këto masa affirmative:**

• Neni 10

Në kushtet dhe kriteret e njëjta, të cekura në nenin 9 do të kenë përparësi studentët e familjeve të dëshmorëve, të viktimate civile të luftës, të veteranëve, invalidëve të luftës dhe **studentet e gjinisë femrore**

- Rregullorja për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvensioneve, nr.01-013/1706

• Neni 17

Përparësi gjatë ndarjes së subvensioneve për zhvillim ekonomik

1.2 **Grave, të rinjëve, zonave rurale, personave me aftësi të kufizuara dhe komunitetet pakicë**

\* Neni 19

Subvencionet në bujqësi

2. Gjatë ndarjes së subvensioneve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:

2.1 **Grave, të rinjëve, personave me aftësi të kufizuara dhe minoritetave**

**Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës së Vitisë, nr.01-110/05/183. E datës 31.03.2021**

• Neni 5

Formimi i Këshillave Lokale dhe kriteret e përgjedhjes

2. Këshilli duhet të përfshijë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagje. **Përbërja e këshillave të fshatrave locale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore.** Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30% të gjinisë femrore. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillat lokal nëse marrin pjesë në tubimin zgjedhor

**Rregullorja për Ngarkesa, Taksa dhe Gjoba, nr.01-110/05, e datës 29.09.2022**

• Neni 5

Drejtoria për Administratë

## **Taksat pér lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare**

Neni 6

Nga pagesat e sherbimeve të kryera komunale sipas paragrafit 5.1 dhe 5.7, lirohen

- a) Shfrytëzuesit e ndihmës sociale, personat të cilët parashtronjë kërkesa pér ndihmë sociale, personat të cilët parashtronjë kërkesa pér ndihmë financiare pranë Drejtorisë pér Shëndetësi dhe Shërbime Sociale, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës dhe anëtarët e familjeve të tyre, familjet e viktimate të luftës, **personat me aftësi të kufizuar, komuniteti RAE**, personat mbi moshën 65 vjeçare, **gratë kryefamiljare dhe fëmijët e tyre nën moshën 18 vjeçare**

- Neni 9

Drejtoria pér Arsim

9.5 Nga Neni 9.1 pér pagesë, lirohen fëmijët e dëshmorëve dhe fëmijët e invalidëve të UÇK-së, **personat me aftësi të kufizuar**, veteranët e luftës dhe anëtarët e fëmiljeve të tyre

\* Neni 12

Drejtoria pér Shërbime Publike dhe Emergjencë

Paragrafi 12.1.7, pér raste sociale, familje të dëshmorëve, invalidët e luftës, **personat me aftësi të kufizuar** dhe veteranë, furnizimi me ujë bëhet falas

- Neni 18

18.1 Nga ngarkesa pér leje të automjeteve lirohen familja e ngushtë e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe **personat me aftësi të kufizuar**

- Neni 24

Drejtoria pér Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

24.1 Në QKMF **Personat me aftësi të kufizuar**, lirohen nga të gjitha pagesat sipas Strategjisë Nacionale dhe Lokale pér PAK-të, **gratë kryefamiljare**, **viktimat e dhunës në familje** dhe **viktimat e trafikimit me qenie njerëzore**

\* Neni 25

Lirim inga pagesa në Qendrën pér Punë Sociale, pér këto kategori:

- a) Shfryetëzuesit e ndihmës sociale, invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve, veteranët e luftës dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngushtë, **personat me aftësi të kufizuar**, viktimat e luftës dhe familjet e tyre të ngushta, **viktimat e dhunës në familje** dhe **trafikimit**

**2. Zyra e Informimit mban të dhan të rregullta pér pjemsarrjen e garve në proceset vendimmarrëse, në konsultimet publikem ku per vitin 2024, nga 267 pjesmarres 52% e tyre jane gra**

**3. Grupi i Grave ka organizuar 2 takime per integrimin gjinor dhe lidership, ku pjesmarrës nga këto dy takime janë 25 gra nga pprofile të ndryshme**

**4. Me 8 Mars eshte mbajtur tryeza me temë “ Barazia Gjinore, progresi I arritur dhe sfidat”, ku ne kete tryeze kanë marrë pjesë përfaqësues nga të gjitha grupet e interest (20 Pjesmarrës)**

**5.Në kuadër të fushatës së “16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës në familje” janë organizuar aktivitetet të shumta, ku ndër to veçojmë: shpërndarja e posterave me moton “ As edhe një më shumë, raporto dhunën, mos hesht”. Posterët janë shpërndarë nëpër shkollat e komunës së Vitisë dhe vendet më frekuente nga qytetarët, është organizuarë tryezë diskutimi me Mekanizmin Kordinues kundër dhunës në familje si dhe ligjérata nëpër shkollat e mesme të larta në Viti, ku përfitues nga këto ligjérata janë 250 nxënës.**

**6. Hartimi I Kodit të Etikës dhe sanksionimi I ngacmimit seksual në vendin e punës  
P.S tashmë ekziston edhe Kodi Etik për zyrtarët public nga MAP-i ku veç të tjerash  
sanksionon edhe ngacmimin seksual në vendin e punës**

**7. Janë mbajtur dy trajnime për ngacmimet seksuale në vendin e punës, ku kanë përfituar 30 shërbyses civil. Këto trajnime janë organizuar nga Agjensioni për Barazi Gjinore në bashkëpunim me IKAP-in**

**8. Përfshirja e gjuhës së ndjeshme gjinore është bërë në KAB, tashmë në Hartën Zonale e cila është duke u hartuar, ndërsa dokumente të reja nuk ka pasur, ndërsa në ato ekzistuese nuk kemi filluar në plotësim ndryshimin e tyre vetëm shkaku I mospërfshirjes së gjuhës së ndjeshme gjinore, por do t'a propozojmë që të bëhet plotësim ndryshimi I tyre dhe të përfshihet gjuha e ndjeshme gjinore**

**9.Komuna e Vitisë ne mbështetje te Un Ëomen ka organizuar trajnim per zyrtaret komunal, me temë ‘ Intgrimi gjinor ne politikat publike komunale” ku ne kete trajnim kane marr pjesë 20 zyrtarë komunal, prej tyre 12 burra dhe 8 gra**

**10. Komuna e Vitisë/ZBGJ në mbështetje të UN Ëomen, ka organizuar trajnimin me temë” Buxhetimi I përgjegjshëm gjinor”, në të cilin trajnim kanë marrë pjesë 18 zyrtar komunal, prej tyre 7 burra dhe 11 gra**

**11. Komuna e Vitisë ka bërë analizë gjinore në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje në të gjitha njësitë buxhetore, ndërsa në kategorinë ekonomike subvensione ka bërë analizë gjinore në sektorin e bujqësisë si dhe në atë të kulturës, rinisë dhe sportit, ku edhe janë ndërtuar edhe rekomandime të reja të cilat janë inkorporuar në KAB**

**12.Në çdo konsultim public që organizon komuna, bëhet ndarja sipas gjinisë nga lista e pjesmarrësve**

**13. janë mbajtur dy takime me këshillat e fshatrave për të nxitur qytetarët për pjesmarrje në dëgjimet buxhetore, ku edhe është rritur numri, posaçërisht I femrave ku për vitin 2024 nga numri I përgjithshëm I pjsemarrësve 267, 149 prej tyre janë femra apo shprehur në % 55.81%**

- 14. Në faqen zyrtare të komunës ekziston vegëza për barazi gjiore ku janë të publikuara të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore**
- 15. Nga komuna e Vitisë, përqindja e grave / vajzave që kanë përfituar subvensione në bujqësi nga komuna për vitin 2024 është rritur në 16%, krahasuar nga viti 2023 që ishte 14 %, ndërsa kjo % pritet të rritet shkaku që kriteri në çdo thirrje për grante I ipet përparësi përfitimit të grave/vajzave**
- 16. Në rregulloren për ndarjen e subvensioneve është e përcaktuar se, në ndrajen e subvensioneve në kushte të barabarta përparësi u jepet grave/vajzave**
- 17. Drejtoria e bujqësisë në kuadër të saj ka zyrën këshilluese e cila vazhdimisht mban trajnime me fermerë, për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore si dhe përdorimin e pajisjeve në bujqësi. Gjithashtu mban edhe sesione informuese për aplikim në grante të shpallura për ndarje të subvensioneve. Për vitin 2024 ka mbajtur 3 trajnime me fermerë**
- 18. . Drejtoria e bujqësisë në kuadër të saj ka zyrën këshilluese e cila vazhdimisht mban trajnime me fermerë, për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore si dhe përdorimin e pajisjeve në bujqësi. Gjithashtu mban edhe sesione informuese për aplikim në grante të shpallura për ndarje të subvensioneve. Në këto trajnime pjesmarrëse janë edhe gratë fermere. Për vitin 2024 ka mbajtur 3 trajnime me fermerë**
- 19. Sa I përket përdorimit të mediave sociale, komuna në fyshën e saj ka rrjetin social facebook, ku përmes saj bën njoftimin për thirrjet për grante në bujqësi dhe i inkurajon të gjithë férmerët për aplikim, në veçanti fermeret femra, ndërsa në media sociale nuk ka pasur njoftime**
- 20. Komuna e Vitisë ka qenë duke e implementuar projektin për të drejtat pronësore, project ky I financuar nga USAID, ku në kuadër të këtij projekti kanë qenë edhe aktivitetet vetëdijësuese për trashëgiminë në pronë të grave, mirëpo projekti është anuluar dhe së shpejti në bashkëpunim me Drejtorinë për Pronë dhe Kadastër do t’I fillojmë sesionet informuese**
- 21. Komuna e Vitisë, gjegjësisht Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për çdo vit, në muajin gusht organizon panairin tradicional “t’I ruajmë vlerat tonë tradicionale”, ku në këtë panair I cili zgjat 3 ditë, gratë bëjnë promovimin dhe shitjen e produkteve të tyre. Produktet e grave fermere, promovohen dhe shiten edhe në 13 kiosqe të vendosura në një pjesë të qytetit, nga komuna për këtë destinim. Gjithashtu disa fermere kanë rritur kapacitetet e kultivimit të produkteve në perimo kulturë, ku produktet e tyre I shesin edhe në tregje ndërkontinentare.**
- 22.Sa I përket pjesëmarrjes së grave fermere në panaire ndërkontinentare janë 2 fermere të cilat subventionohen nga komuna por edhe nga ministria e bujqësisë për pjesmarrje në panaire ndërkontinentare për të promovuar produktet e tyre**

- 38. Policia e Kosovës dhe psikologu shkollor ka mbajtur 4 ligjérata në shkollat fillore të komunës së Vitisë për bullizmin që është mjaftë I theksuar në shkolla, gjithashtu ligjérata janë mbajtur edhe për pasojat e keqpërdorimit të rrjeteve sociale**
- 39. Komuna e Vitisë ka ndarë subvensione për 2 klube sportive të femrave që operojnë në komunën e Vitisë, subvensione për dy përfaqësueset për klubin e shenjtarisë për pjesmarrje sportive qështë mjaft I vogël**
- 40. Për çdo thirrje për grante nga komuna, organizohet takimi informues për të interesuarit për aplikim për marrjen e granteve. Kjo organizohet nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e cila ndan edhe grantet**
- 41. është mbajtur një trajnim me mësimdhënësit e edukimit fizik për t'I inkurajuar vajzat që të merren me aktivitete sportive dhe të formojnë klube sportive (mbështetur nga Unëomen). Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 12 mësimdhënës të edukimit fizik**
- 42. Janë mbështetur disa OJQ që udhëhiqen nga femrat/grat si p.sh OJQ "IMADNJ", OJQ "YOU CAN DO", OJQ "NEUTRUON", OJQ "KFF PRESINGU" e të cilat përveq që udhëhiqen nga femrat edhe antarsia e tyre përbëhet nga to dhe aktivitetet e tyre e kanë në fokus barazinë gjinore.**
- 43. Janë mbajtur trajnime me vajza të shkollave të mesme dhe studentët në lidhje me angazhimin e tyre në aktivitete sportive, nga këto trajnime dhe fushata vetdijsuese është rritur numri i femrave në klubin e futbollit të femrave "Pressingu" dhe klubin e basketbollit "Vitia",**
- 44. Në përgjedhjen e artistit të vitit ka pasur plotësisht barazi gjinore, artiste e vitit është zgjedhur solistja Naile Halili.**
- 45. Janë organizuar 2 ekspozita si p.sh kuratorja Jalldëze Mustafa, Irena Toma**
- 46. Në bibliotekën publike komunale ka libra me autore femra por ka nevojë ende për rritjen e tyre.**
- 47. Në vitin 2024 është renovuar QKMF-ja në Viti, QMF-ja në Pozheran, QMF-ja në Sadovinë dhe AMF në Stubëll. Që të gjitha këto janë renovuar me standard për një shërbim cilësor, ndërsa në QKMF është rregulluar edhe ashensori për qasje më të lehtë në kryerjen e shërbimeve që ekzistojnë në QKMF**
- 48. Janë mbajtur 2 sesione informuese për shëndetin seksual dhe riprodhues**
- 49. Në kuadër të fushatës vetëdijësuese për kancerin e gjirit janë mbajtur 10 takime në shumicën e lokaliteteve të komunës së Vitisë**

- 50. Janë mbajtur 12 trajnime të stafit shëndetësor mbi rëndësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore**
- 51. Janë realizuar 1360 vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë**
- 52. Janë mbajtur 2 sesione informuese me stafin shëndetësor për shëndetin mendor**
- 53. Janë mbajtur dy sesione informuese për kancerin e qafës së mitrës me gra dhe vajza**
- 54. Gjatë muajit rozë është bërë mamografi falas për 121 gra**
- 55. Gjatë muajit rozë është bërë ultrazëri I gjirit falas për 80 gra**
- 56. Janë mbajtur 13 sesione informuese me prindër për vaksinimin e vajzave të grupmoshës 11-13 vjeçare për vaksinën HPV**

Viti, Maj 2025

Ibadete Hyseni

ZBGJ

